



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.268/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit R. Z., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.142/23 të datës 06.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.850/2023, të datës 23.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses të dënuarit R. Z., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.142/23 të datës 06.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.850/2023, të datës 23.10.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin P.nr. 142/23 të datës 06.06.2023, të dënuarin R. Z., e ka shpall fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me nën paragrafin 1.4. të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dënuari është liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale. I dëmtuari A. Z. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 86 të KPP-së të dënuarit i është shqiptuar Masa e Trajtitimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri e cila do të ekzekutohet në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor-Qendrën e Shëndetit Mendor në P.. I dënuari urdhërohet ti nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në

liri dhe të paraqitet në qendrën e shëndetit mendor në P., sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve-ekspertëve, gjithashtu ta përdorë terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve mjekësor. Gjykata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, kur i pandehuri nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kur kryesi braktis trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri. Kjo masë do të zgjasë për aq kohë sa i dënuari do të ketë nevojë për trajtimin e derisa të eksitojnë kushtet mbi të cilat është caktuar kjo masë, por nuk mund ti tejkalojë tri vite. Institucioni i kujdesit shëndetësor – Qendra e Shëndetit Mendor në P., obligohet që ti dërgoi gjykatës raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit për të pandehurin, së paku njëherë në gjashtë muaj dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.850/2023 e datës 23.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër aktgjytimeve të kundërshtuara, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

-Mbrojtësja e të dënuarit R. Z., avokate Ylberza Glllogjani Krasniqi, pa i potencuar bazat për paraqitjen e kërkesës, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.149/2024 e datës 29.04.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi.1 lidhur me nenin 436 paragrafi.1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësja i të dënuarit në kërkesë, pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, është dashur ti marrë parasysh shumë rrethana të cilat nuk i ka marrë gjatë matjes së dënimit, e veçanërisht rrethanën se kryesi i veprës penale duhet të jetë i aftë mendërisht për të kryer veprën penale. Tutje në kërkesë theksohet se gjykata është dashur të vlerësoj pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë të dënuarit, sepse pranimi i fajësisë është rrethanë posaçërisht lehtësuese.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtëses të dënuarit janë të pabazuara.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtëses të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar e ka bërë pranimin e

fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimit i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast duhet theksuar fakti se pranimit i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtëses të tij.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të dënuarit i është shqiptuar dënim i lartë. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënim i përcaktuar në suaza të dispozitës së lartcekur për veprën penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Pretendimi i mbrojtëses se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit të dënuarit është i pabazuar. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të dy gjykatat e instancave më të ulëta drejtë i kanë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit dhe shqiptimit të masës ndaj të dënuarit, për këtë dy gjykatat kanë paraqitur arsyetim të mjaftuar dhe të plotë në aktgjykimet e tyre e me të cilat arsyetime pajtohet edhe kjo gjykatë pa dashur që edhe njëherë të bëjë elaborimin e tyre.

Pretendimin e mbrojtjes se gjykata është dashtë të vlerësoj rrethanën se kryesi duhet të jetë i aftë mendërisht, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vlerësuar edhe këtë rrethanë për faktin se i dënuari veprën penale e ka kryer në gjendjen e aftësisë së zvogëluar mendore, të cilën rrethanë gjykata ja ka vlerësuar në kuadër të rrethanave lehtësuese.

Në pajtim me nenin 18 paragrafi 2 të KPRK, personi i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërliqej me

mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.268/2024, më datë 15.05.2024

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit
Agim Maliqi